

Protokoll për veprim të shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për realizimin e procesit edukativo – arsimor me prani fizike të nxënësve në vitin shkollor 2020/2021

1 Procesi mësimor në shkollë zhvillohet nga ora 07:00 deri ora 20:00.

- 2 . Shkolla për hyrje dhe dalje të nxënësve vendos në funksion të gjitha hyrjet e objektit shkollor dhe përgatit orarë për hyrje/dalje në kohë të ndryshme për hyrjen dhe daljen e nxënësve për çdo klasë dhe e vendos në vende të dukshme në shkollë.
3. Materialet edukative-informuese dhe udhëzimet për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në shkollë vendosen në hyrje të shkollës, në korridore dhe në klasa.
- 4 Nxënësit në secilën hyrje të shkollës i pret mësimdhënësi kujdestar, i cili kujdeset që nxënësi t'i dezinfektojë këpucët dhe duart, përkatësisht i ndihmon nxënësit t'i dezinfektojnë duart me mjete dezinfektuese.
5. Shkollat duhet të vendosin shenja që tregojnë drejtimin e lëvizjes dhe kujdesen për distancën minimale të kërkuar gjatë pritjes në radhë të nxënësve para dhe brenda shkollës.
6. Të gjithë punonjësve dhe nxënësve në hyrje të shkollës ju matet temperatura e trupit dhe në rast të rritjes së temperaturës (mbi 37.4 °) punonjësi ose nxënësi drejtohet tek mjeku amë.
7. Nxënësve të cilët udhëtojnë ,me transport të organizuar,u matet temperatura para hyrjes në autobus dhe bëhet dezinfektimi i duarve dhe këpucëve, Nxënësit që kanë temperaturë (mbi 37.4°) kthehen në shtëpi me rekomandim që prindi të marrë masat e nevojshme shëndetësore.
8. Hyrja në shkollë lejohet vetëm me mbajtjen e detyrueshëm të maskës mbrojtëse / mbulesës së fytyrës për të gjithë punonjësit dhe nxënësit në shkollë.
9. Të gjithë punonjësit dhe nxënësit duhet të respektojnë masën për distancë fizike të paktën 1.5 metra.
10. Dezinfektuesit vendosen në hyrje të shkollës, si dhe në klasa dhe hapësirat e tjera të shkollës .
11. Punonjësit duhet të dezinfektojnë këpucët dhe duart para hyrjes në shkollë .
12. Ndalohen të gjitha llojet e kontaktit fizik për përshëndetje midis punonjësve të shkollës dhe nxënësve .
- 13 Shkëmbimi i informacioneve me njeri-tjetrin dhe takimet e punës në shkollë duhet të realizohen duke shfrytëzuar një lidhje video konferencash.

14. Nxënësit vijnë dhe shkojnë vetë nga shkolla të shoqëruar nga një prind / kujdestar / kujdestar arsimor ose asistent personal (për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore), me transport të organizuar dhe publik.

15. Nxënësit dhe punonjësit në shkollë respektojnë protokollin për transportin e udhëtarëve me transport publik (linku me protokollin).

16. Ndalohet hyrja e prindërve / kujdestarëve përveç nxënësve me nevoja të veçanta arsimore me respektimin e detyrueshëm të masës për distancë fizike dhe mbajtjen e maskës në fytyrë/mbulimi i fytyrës .

17. Bartja e informacioneve dhe takimet me prindërit/ kujdestarët bëhen përmes telefonit ose përmes ndonjë aplikacioni online për të cilën do të merren vesh prindërit dhe mësimdhënësit

18. Mësimi në klasë realizohet më së shumti me 20 nxënës në klasë dhe sigurohet distancë fizike prej 1,5 metër ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësve dhe nxënëse ndërmjet vete.

19. Për realizimin e trajnimit praktik dhe të mësuar përmes punës,shkolla përgatit një orar për përdorimin e kapaciteteve shkollore ku e vendos në vend publik të shkollës. Përdorimi i kapaciteteve shkollore është e detyruar të respektojë të gjitha protokollet ,për sigurinë e nxënësve.

20. Nxënësit dhe mësimdhënësit përgjegjës duhet të respektojnë protokollet e ndërmarrjeve (në repartet, hapësirat higjienike- sanitare, njësia e të ushqyerit dhe të gjitha pjesët tjera ku mund të lëvizin nxënësit në kompani).

21. Marrëveshjet e trajnimit praktik dhe mësimi përmes punës së punëdhënësit plotësohet me dispozitat e caktuara, të cilat rregullojnë realizimin e trajnimit në kushte pandemie - Covid-19.

22. Përdorimi i sallës sportive, bibliotekës dhe mjediseve të tjera rekomandohet të jetë nga një grup nxënësish të të njëjtës klasë, në mënyrë që të mos ketë mundësi për përzierjen e nxënësve nga klasa të ndryshme për të cilat shkolla përgatit orar paraprakisht (p.sh. gjatë 1 ore të mësimit, një klasë është në palestër, dhe dy klasa janë jashtë në oborrin e shkollës ose në terrenet sportive).

23.Përdorimi i tualeteve organizohet në mënyrë që të mundësohet prani më e vogël e nxënësve dhe mbajtja e distancës (p.sh. nëse tualeti është i vogël nxënësi duhet të pres jashtë tualetit derisa të dalë nxënësi i cili gjendet brenda)edhe atë gjatë orëve të mësimit për të cilat nxënësit informohen në kohën e duhur.

24..Pastrimi i klasave bëhet para fillimit të mësimit, gjatë kohës së pushimit kur nxënësit janë në oborrin e shkollës dhe pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve, me ujë dhe sapun/ detergjent dhe me mjete dezinfektuese i cilin vepron ndaj viruseve sipas udhëzimeve të prodhuesit.

25. Tualetet duhet të jenë funksionale në mënyrë që të sigurojnë kushte për larjen më të shpeshtë të duarve me ujë dhe sapun dhe më shpesh të pastrohen duke mbajtur shënime të obligueshme për pastrimin dhe dezinfektimin me mjetet të cilat veprojnë ndaj viruseve sipas udhëzimeve të prodhuesit në mënyrë alternative mund të përdoret hipoklorit të natriumit 0.1 % (5% zbardhues për amvisëri i cili përdoret në raport 1:100) ose 70 % alkool për dezinfektimin e hapësirave të sipërme.

26 Koridoret, shkollat dhe hapësirat tjera të përbashkëta pastrohen më së shpeshti, derisa nxënësit janë në mësim dhe pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve shkollore.

27.Pastrimi i sallës së fizkulturës dhe fushave sportive, zhveshtoreve , dhe hapësirave tjera ndihmëse, bëhet menjëherë pas shfrytëzimit nga ana e çdo grupi të nxënësve

28. Shkollat zbatojnë sistem për lëvizje njëkahëshe të nxënësve nëpër hapësira si dhe kufizojnë numrin e personave të cilët njëkohësisht janë të pranishëm në zhveshtore si dhe daljet e kontrolluara dhe hyrjet në zhveshtore .

29.Hapësirat duhet të ajrosen pas çdo ore,të paktën gjysëm ore para ardhjes dhe shkuarjes së nxënësve, dhe nëse lejojnë kushtet klimatike , preferohet që dritaret të qëndrojnë të hapura gjatë orës mësimore .

30. Hyrja e personave të tjerë duhet të shmanget (për shembull, për pastrimin, riparimin ose sjelljen e ushqimit në klasa për sa kohë që nxënësit janë mbrenda në klasë ,si dhe hyrja në objektin e shkollës të personave që nuk janë të punësuar në shkollë ose fëmijëve që nuk janë nxënës të asaj shkolle.

31. Dërgesat për nevojat e shkollave merren nga përgjegjësit punonjësit në shkollë nga hyrja dytësore e shkollës.(nëse shkolla ka një hyrje të tillë)me respektimin e detyrueshëm të masës për dezinfektimin e duarve dhe nëse është e nevojshme mbajtja e maskës-mbrojtëse / mbulese dhe mbrojtëse për këpucët.

32. Nëse në shkollë shfaqet ndonjë person me KOVID-19 ose personi që ka pasur kontakt me person të infektuar me KOVID-19, personi duhet të izolohet në hapësirë të veçantë me mbajtjen e detyrueshme të maskës / mbulese mbrojtëse,ndërsa drejtori duhet të krijojë komunikim me Qendrën për Shëndet Publik për udhëzime të mëtutjeshme.Shkolla paraqet raport mbi aktivitetet e ndërmarra në komunë, dhe komuna në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

33.Nëse nxënësi shfaq simptoma të KOVID-19 derisa është në shkollë, mësimdhënësi /bashkëpunëtori profesional e izolon nxënësin në hapësirë të veçantë me mbajtjen e detyrueshme të maskës / mbulesës së fytyrës dhe menjëherë të njoftoj prindërit / kujdestarët, të cilët duhet ta marrin,fëmiun sa më shpejt me qëllim që të konsultohet për udhëzim të mëtutjeshme me mjekun amë të nxënësit.

34. Nëse konfirmohet që një nxënës është i infektuar me KOVID - 19, atëher të ndjeken protokollet e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa shkolla të konsultohet me Qendrën për Shëndet Publik, për veprime të mëtutjeshme për klasën të cilës i përkiste nxënësi.

35. Organizohet shërbim për mbajtjen e rendit, me qëllim të mbajtjes së rendit dhe mbajtjes së distancës së nevojshme në mes nxënësve minimum prej 1,5 metër edhe atë 2 roje para hyrjes në shkollë dhe 2 roje në shkollë. Rojet angazhohen nga stafi i punonjësve në shkollë, ku vendos drejtori I shkollës së mesme.